

# Lot kurbeti

## **S'ia gjej dot shoqen Shqipërisë**

Thyhem, përthyhem bëhem sa një gisht  
në tokmakun e viteve e shkërmoqëm  
vështrimin e hedh në Zot e në Krisht  
po Shqipes s'ia gjej dot shoqen.

S'ia gjej dot shoqen dykrenare  
se brezat që ikën e murosën  
e zbritën nga qiej, e ngritën nga varre  
në shtizë bajraku e vendosën.

Në sfond gjakun e kombit i vunë  
gjakun që vërtitet në damarë  
si breza të tërë dhe unë  
gjakun flamurit ia kam falë.

Mbulomëni me të, priftërinj nuk dua  
asnjë lloj apostoli s'përfill në botë  
Shqipja për një çast do ulet mbi mua  
dhe syrin do ma gjejë me lot.

## **Vdekja e gradaçelave**

Gradaçelat ranë  
Bota, në gjunjë në rrënoja të tyre  
qiellin mallkon për herë të parë  
Komb i mrekullive.

Vdekje e tillë nuk ka ndodhur  
dridhen fletët e historisë nën kapak  
vrasësit qen rrugësh të ngordhur  
martirët kullojnë gjak.

Bomba ngarkuar me elementin "Jetë"  
lëvizi në tabelën e Mendelejvit, uranin  
retë atomike i ngriti përpjetë  
për një gjysmë ore e shkatëroi Manhattanin.

Planeti ngriu, aisberg i rumbullaktë  
ndali udhën e tij në galaktikë  
vetëm loti i diellit, aq i zjarrtë  
e përmendi prapë, i dha jetë.

Dhimbja njerëzore u përplas për eteri  
dhe prapë u kthye në tokën mëmë  
dinake, e pabesë kjo pjellë, nga erdh?  
Me grusht demokracie do qëlluar rëndë.

Dhe shpejt, se nuk pret koha  
t'i zëmë pritën ligësisë  
ndryshe do mbetet bota  
nën urdhëra të harbutërisë.

2.

Ku ishe, Zoti ynë  
atë mëngjes të përgjakur?  
ku i le njerëzinë?  
Pse le shtegun hapur?

Pse le vathën tënde  
të shkretë pa bari?  
Pse humbe atë mëndje  
pse mbylle njërin sy?

Pse lutjet si dëgjove  
s'erdhën tek ti vallë?  
Më duket, Zoti im  
e shkele këtë radhë.

Botën e përmyte  
kur s'u bë e mirë  
dhe s'ndenje pak vite  
sa ribëre njerinë.

Në varkë të Noes  
pse i vure radhë  
vure dhe të ndershëm  
vure dhe kusarë?

Përse vure vrasës  
me thikë në gojë  
përse nuk i zgjodhe  
e kishe në dorë?

Që botën ta kishe  
si e doje ti  
të mos bëje kafshë  
që ngjan si njeri.

Më fal, Zoti im  
që dalldisa pak  
Për një gabim tëndin  
u ngop toka gjak.

T'i lëmë të vjetrat  
po ndihmona sot  
të mos ngashërehemi  
të mekur në lot.

3.

Si e bëre, pse e bëre o zagar  
u mallkofsh, e pësosh, u heqsh zvarrë!  
u dhunofsh e lëngofsh, o i marrë  
mos të mbiftë, u zhubiftë ajo farë!

Gjarpër mali e nepërkë, helm e vrerë  
ditë e motit mos të zëntë, pse s'të merr  
o i shtyrë, i pështyrë që në djep  
humbtë emri edhe varri mos 'tu gjet.

Mos gëzofsh, u rrëgjofsh gjithë tmerr  
u kallofsh e pikofsh pikë sere  
u sterroftë, u ferrostë ajo derë  
që të thotë kush do vijë: Qe një herë

Manhatani ke ditë që lëngon  
hekuri larë gjak, gjaku përzier me beton  
gërmadhë vigane në themel të djepit  
varr i pambyllur në lindje të shekullit.

Qiangërvishësit pushuan  
të ngacmojnë hapësirën, kryeneçe  
në vend të tyre njerëzit piketuan  
një qiellgërvishtës të vërtetë.

Përballë tij çdo lloj armatimi  
do ulë kokën me bisht në shalë  
se është gradaçela e besimit  
që bota s'do të ketë shkalë.

## **E sertë koha që erdhi**

E sertë koha që erdhi  
deshti ta mbushte, e derdhi  
deshti ta vaditë, por thau  
deshti ta mbronte po vrau.

Lanet pastë, lanet qoftë  
na degdisi nëpër botë  
kokrra-kokrra, mos o Zot  
dhe zogjtë s'na mbledhin dot.

Për së prapthi mori filli  
nëna vdes, nuk vjen i biri  
vdes vëllai, s'vete motra  
krokëllin me kuje porta.

Krokëllin hënë më hënë  
veshur e gjithë mëllenjë  
atë vend kujt do t'ia lëmë  
se lindëm e kemi rrënjë.

Gjak e djersë mbrojtëm dhenë  
zili na kanë folenë  
zili folenë na kanë  
po kush ka si trojet tanë?! . .

O ju, djem që keni forrë  
dhe përpara keni jetë  
mos e bëni zemrën borë  
kthehuni se vatra pret.

## **Hapa një vrimë në ujë**

Vura dorën përmbi ballë  
rrudhosur balli i tërë  
botën bëra shalë-shalë  
hapa në ujë një vërë.

Gjithë shkruan, kush nuk shkroi  
dhe shejtani te përroi  
u habit kur e dëgjo  
tha, dhe mua ma kaloi.

U mblodhën, nga qenë e s'qenë  
ca pa shkollë, ca me penë  
dhe zbritën në Tepelenë  
atje tek e kam folenë.

Dola dhe i prita jashtë  
socialistë, demokratë  
skuqur hunda spec e flakë  
habita si qenë bashkë.

Në një gojë, si e thanë  
ku është vrima s'e pamë  
në na tregofsh atë vrimë  
do të japim qeverinë.

Ca që thoshin, s'e ka bërë  
hungërinin në zinxhirë  
o tregojë atë vërë  
ose gjakun do ta pimë.

Ca që ishin "tolerantë"  
dhe dinin ligjet e natës  
më thanë që jemi bashkë  
mos u tremb, o vrimëhapës.

U mblodha, një grusht u bëra  
u zverdhja meit, i shkreti  
po ç'më duhej mua vëra  
pak kish hapur parlamentit?

Kisha shkelur kallo të vjetër  
më mbeti fjala në grykë  
dridhesha i tëri lepur  
isha marrë me politikë.

U kisha hyrë në pjesë  
shkela në liman të tyre  
më dënuan të pabesë  
mora udhën arrative.

Ju, që më lexoni mua  
dhe besoni ndershmërinë  
mos bëni si bëra unë  
ta pësoni për një vrimë.

## **Kopështi i poezisë**

Në atë kopsht, kush nuk është ulur  
më i madhërishmi kopsht i njerëzimit  
atje, lule vetja u është dukur  
e vyshkur, ne prag të mjerimit.

Atje, në poltrone shkullore  
rrinë gjizbërthyer poezitë  
atje, asnjëherë nuk ka dëborë  
dhe bahçevane janë përditë.

Atje, larë në ujvara hëne  
si shtojzovalle spërkatur me vesë  
rrinë rubairat, shkulme zemre  
nusërojnë nga mëngjesi në mëngjes.

Atje, vetëm një gjuhë flitet  
cicërimat e bukura shpirtërore  
dhe janë të papërfillshëm vitet  
se nuk ka as azil, as foshnjore.

Atje, jetohej lulëzorja moshë  
e trëndafilta moshë e rinisë  
në kopshtin, të cilin nuk josh  
në kopshtin e mahnitshëm të poezisë.

## Shqerka

Shkoi shqerka anës lumit  
më tund filladi, më nxjerr gjumin  
shelgu ëmbël degën vari  
ulet sa të puthë barin.

E vogël shqerkëzë  
shkrifsha, të mos mbetem më  
të betohem, s'dua gjë  
buzën mbi gjire të vë.

Po vdekja të mos më marrë  
në s'mbaj betimin e parë  
nga ta di kur digjem prush  
ku ndahet gjiri me gush'.

Në u dehsha, shqerkëzë  
kokën në prehër do vë  
mos e nga e ç'ke me të  
se do bëj sikur do fle.

si trëndelinë lastonjë  
derdhi flokët e mbulomë  
të çlodhem, moj manushaqe  
tek ndahet gusha me faqe.

## Njësoj lindim të gjithë

Era e Pireut në qejf të saj  
kalërote mbrëmjen e vakët të gushtit  
degët e palmave tundeshin ngadalë  
dhe hardhia ëmbëlsonte mushtin.

Dielli i lodhur puthte detin  
dhe perëndimi flakëronte  
më njërin sy afronte natën  
me tjetrin, hemisferën tjetër zgjonte.

Në gjumë zgjuarjen e tij, katrahurë  
njerëzit e planetit gjysmëlakuriq  
gjysma nxitojnë të bien në gjumë  
gjysma mezi shkundin gjumin për qerpikë.

Në këtë moment lakuriqësie  
floriri i jetës tringëllinte rëndë  
globi vërtetë ka dritë e hije  
për ne njësoj lindim të tërë.

## Shenjtaria

Thonë, një herë një plakë  
kishte djalin mullixhi  
i venë dyzet shejtanë  
dhe i thonë: Ç'bën aty?

Bluaj bukën për fëmijë  
i habitur - tha mullisi  
s'e kuptojë nga keni mbirë  
s'u njoh farën, s'u njoh fisin.

Kuqoi kryeshejtani.  
Erdhëm punë të na gjesh  
po s'na gjete bëhet nami  
këtë botë do ta lëshë.

Mendohet e tha mullisi:  
ma bëni mullirin flakë  
në gjetsha thërrime misri  
do t'ju bëj të villni gjak.

U lëshuan të paudhët  
kruaj anë, pastro rrëz'  
e bënë mullinë e vjetër  
sa gjuhën mbi të, të vësh.

I thanë, shiko për nesër  
se këtu do vijmë prapë  
të ta themi kështu esëll  
s'gjete punë bëj hesap.

I lodhur, mullisi i shkretë  
mori udhën për në shtëpi  
vriste mendjen ku të ketë  
punë për shejtanëri.

Dhe ashtu mendjengarkuar  
hapi portën me ngadalë  
nëna që e priste zgjuar  
i nguli sytë në ballë.

Ç'ke, o bir, i thotë plaka  
nuk më thua që ta di?  
ia tregon djali të gjitha  
ç'kishte ndodhur në mulli.

Ti do rrish -i tha e ngrata  
se nesër do vete unë  
pa dhe prapë në mos ardhsha  
e kamë marrë atë udhë.

Mori shkopin, çalë-çalë  
vajti ndenji në mulli  
hodhi sytë mbi shejtanë  
dhe u tha nja dy a tri.

Vështroni këtu në shalë  
kamë një vrimë, s'di se si  
që kur linda më ka dalë  
dot s'e mbyll e bëj çudi.

Thonë mbyllet duke fryrë  
siç e shihni, s'i fryj dot  
po e bëtë këtë të mirë  
vij me ju në atë botë.

Filluan dyzet shejtanët  
fryj e fryj, plasën bullçitë  
vrima mbyllte pakëz anët  
hapej prapë e tjetrin prit.

Po aty në darkë herë  
i shpëtoi plakës një. .  
kryeshejtani në derë  
thotë plakës, Deshe gjë?

Jo-i kthehet plakë e vjetër  
pa vështro seç ndodhi vallë  
mos më hapët vrimë tjetër?  
dhe hodhi syrin në shalë.

U mblodhën dyzet shejtanët  
dhe hipën sipër në tra  
plaka avash mbylli shalët  
edhe sot vrimat i ka.

Që atëherë kanë ikur  
s'ka shejtanë në mulli  
në detyra janë ngjitur  
punojnë në qeveri.

Ndaj ne sa mbyllim një vrimë  
na hapet një vrimë tjetër  
se kemi shejtanërinë  
peshqesh nga një plakë e vjetër.

## **Porta e djalërisë**

Pena më mori me vete  
në portën e djalërisë  
ç'mu mbush kështu krahërori  
gati plasë, sisë më sisë?

Zë e derdhet llava e malit  
i rrafshon vitet e shkuar  
dhe i meket prush i zjarrit  
te porta që s'kam harruar.

Te porta ku fluturimi  
ngrihej zemra, meritë valë  
ndaheha me fëmijërinë  
dhe merrja puthjen e parë.

## **Të isha si Katerina**

Të isha si Katerina  
do mbija derë më derë  
gjithë ç'kisha të qershinjta  
kush do m'i linte pa vjelë.

Ai afsh i përvëluar  
kë vallë s'do vilaniste?  
dhe të ishte briskpashuar  
dhe brenda veriut të ishte.

Te syri qielli i tretur  
dhe deti i kaltri gjithë  
kush kërkoi dhe s'ka gjetur  
limanin e dashurisë.

Nëpër gushën gudulimë  
të gjezdisë flaku azat  
kush i shpuri e s'iu ngjinë  
buzët vetëm në një çast.

Të isha si Katerina  
që ka qeshjen si pranverë  
motet nuk do kishin dimra  
lulet nuk çelnin njëherë.

## I kapitur

I kapitur vjen mëngjesi  
kaq i lodhur s'di përse  
s'ka fuqi të hapë syrin  
të hedhë dritën mbi dhe.

Si i dalë nga lëngata, lëngimi  
mjegullon gjindjen të tërë  
cipë e dheut s'ia ndien hapat  
natën zonjë do të lërë.

Atë natë, errësirë  
që zптоi shpirtin tim  
cili shpirt u ndje mirë  
i degdisur në mërgim.

Cili shpirt e tani daltë  
zoti vendin mos i dhëntë  
nuk kërkon të kthehet prapë  
gjak'i gjakut nuk i dhëmb.

I kapitur vjen mëngjesi  
i kapitur jam unë  
errem, gdhitem i sfilitur  
gjizhuritur, i papunë.

## U rimbush një vesë shi

U rimbush një vesë shi  
sa njomi lulet e shkoi  
si lot i mbetur në sy  
që u nis e nuk pikoi.

I la gjethet buzënjomur  
u mbështet në një kodrinë  
të çlodhej, sikur ish lodhur  
u mbështoll e qepi synë.

Qerpiku gjumëvenitur  
në përgjumë zëra vijinë  
po hajde se të kam pritur  
i lutej një përcëllime.

Hajde se të kërkon djepi  
që ka marrë për të tharë  
zbraze gjirin, bëj rrëmetin  
të dalë burimi i parë.

Bjer mbi supë përcëlluar  
hiqma këtë djegësirë  
që kur linda kam gatuar  
për mikun bukë të mirë.

U rimbush një vesë shi  
thashë ra atje ku doja  
po të isha si ai  
dhe pikën do ta kulloja.



## U kalb loti kontinentit

Dimri këmbëkryq  
përmbi vatrën tënde  
supet lakuriq  
skuqur, ndjejnë dhimbje.

Flokët përmbi ballë  
copë e harruar  
mbetur aq e rrallë  
mbi rrudhat thelluar.

Vetullat mbërthyer  
si shkëmbinj të rëndë  
gati më të shkukur  
gati më të rënë.

Syri vetëtimë  
s'të shkrep si më parë  
kur një suferinë  
qante me qepallë.

Loti është kalbur  
përtej kontinentit  
ç'mallkim paskam patur  
ninullat e djepit.

2.  
Ç'mallkim paskam patur. . . . ?  
nëpër sterë  
ikim si të çartuar  
dhe s'kthehemi prapë.

Bota po na shtyjnë  
hallin s'na i qajnë  
gjakun po na pijnë  
në kular na mbajnë.

Ne, pleksur zinxhirët  
si sklevër të lindur  
sikur s'kemi emër  
sikur s'kemi lindur.

Sikur s'kemi varre  
sikur jemi tharë  
sikur ndër të parët  
nuk jemi të parë.

sikur dashurinë  
nuk e njohëm kurrë  
shohim njëri-tjetrin  
e zëmë me gurë.

3.  
Sikur erë gjiri  
kurrë s'kemi marrë  
njerëz ndershmërie  
na thonë kusar.

Dhe na bluhen vitet  
në mulli harrese  
dhe pse jemi rritur  
në lëndina vese.

Dhe Zoti habitet. . . !  
kur hyjmë tek dera  
s'themi tungjatjeta  
po gjuhë të tjera.

Me emër nderuar  
bredhim gjithandej  
me kurizin shtruar  
si pa gjak në dej.

Po ngriheni kokën  
vëllezër të gjakut  
se Nënë si tonën  
asnjë komb s'ka patur.

4.  
Thar balli i saj  
nëpër shqote lufte  
thyer vetëtima  
me të, plagët supe.

Djegur e zhuritur  
po kurrë dhunuar  
prehëri ranitur  
po lavdia shtuar.

Dhe i flisnin Zonjë  
se peshonte rëndë  
mpikste hidhërime  
gatuante këngë.

## Marina

Vërtet ishe e tillë  
flokëhënë, moj Marinë  
sa dhe sot në atë brinjë  
erëra meraku fryjnë?

Erëra sevdaje çartuar  
pak cingërisur, ndezur gjakun  
të madh tundim që ka patur  
s'më thua si e ke mbajtur?

Ku ta gjeje, nuk është gjallë  
kush bëri, këngën e parë?  
përse s'të hipi në kalë  
apo për ty s'u gjen djalë?

Apo zjarri yt Marinë  
e përvëloj të zinë  
sa s'gëzoi djalërinë  
në shandan gjiri e shkrinë.

Vërtet ishe e tillë  
Nuk lije zemër pa zgjuar  
Maro, e bukur Marinë  
sevda me maraz mbuluar.

## Bini ëmbël, ju longarë

Të prita, pse s'erdhe  
malli më kisha marrë  
bini ju, o cula  
bini ëmbël, ju longarë.

Kjo sevdaja jote  
erë manxuranë  
u ul dritë e hënës  
të ndenji në ballë.

U ul dritë e hënës  
ndenji mbi qerpikë  
të të ndriste udhën  
për te unë moj vitë.

## U këput një lule e radhë

U këput një lule e rrallë  
u këput po ku qëndroi?  
cilën ngau vallë  
cilën zemër dashuroi?

U këput një lule e rrallë  
e bardhë si borë mali  
nëpër ç'shtigje shkoi vallë  
po ç'i tha qerpikut të djalit?

Shko, moj shko, lulja me erë  
m'u bëre avaz longari  
të dua: s'më the një herë  
nëpër këngë e derdha mallin.

O, moj vetulla shushunjë  
faqekuqja si shega  
ç'ke me ëndrrat, pse mi trëmb?  
ç'ke që nuk mi lë të qeta?

Ç'më shkel ashtu majë këmbe  
mbi tërfil në lëndina  
unë që e njoh gjurmën tënde  
di ta ngre dhe pusinë.

## Tepelenë, kujto djemtë

Hodo Nivicën e shkretë  
që të ra me malazeztë.  
Gjolekë e Hodo Aliun  
ajo pallë që pret vetiu.  
Tepelenë, kujto djemtë  
trembëdhjet bilbilentë  
vanë në litare vetë.  
Bilbilin kur djeg cingarë  
kërkon që beu t'i dalë.  
Tepelenë, nënë e rallë  
në Vlorë përmbi spitalë  
Selamin e ke të gjallë.  
Selam Musa Salarisë  
me barutin i dha sisë.  
Tepelenë, hallemadhe  
gjiri i luftës partizane  
me 400 lapidarë  
400 a qenë më shumë  
gjiri yt nuk shteri kurrë.

## Katërshes së Hormovës

Ç'pate pikë e lotit  
në qerpik më mbete  
mos je pikë shiu  
mos je pikë vese?

Ku e gjetën djemtë  
atë gurgullimë  
sikur trimat  
në këngë më vijnë.

Po ç'patën bedenat  
që e lanë kalanë  
vetë vajtën te skena  
djemve çfarë u thanë?

1). .  
Lulet u thanë  
hasmi zu vatanë  
foshnjat po qajnë  
flaka mbuloi fshanë.  
Nxirni jataganë  
zini istikamë  
keni nënat pranë  
o ju, djemtë tanë

Ç'pate pikë e lotit  
në qerpik m'u trete  
djemtë i binin culës  
unë flisja me vete.

1) Katërshia e Hormovës, ftoi çmimin e pare në festivalin folklorik të Gjirokastrës, 1988

## Anës valëve më vije

Përtej bregut, anës valëve  
më vije  
ndarë një kaçurel nga shoqet  
të kish hije.  
Nishanin si pikë e lotit  
përmbi faqe  
mos e prek ashtu me dorë  
se më plase.  
Frynte filladi lehtë-lehtë  
nga Gërzhuni  
qerpikun mbi synë e shkruar  
të përkundi.  
Dola vetë, shtegun të zura  
të të flisja  
çelën gonxhe karafilat  
kur të flisja.

## Mbi lule qershie

Mbi lule qershie  
derdhi hëna dritë  
pikonte nga lulet  
të binte te sytë.

Hëna e bukur natën ndriste  
dëgjoj zemrën, fliste  
thosh hallin që kishte  
vasha te qershia priste.

Pse s'e thua hallin  
kur sheh syri-synë  
dita shuan mallin  
netët ëmbël vijjnë.

Ç'u këput nga dega  
një lule e bardhë  
thashë ndenji mbi flokë  
thashë ndenji mbi ballë.

Më ndenji mbi buzë  
më pruri beharë  
më ndezi në zemër  
zjarr që s'kesh parë.

## Një jetë që mbeti lot

1.  
Pllakosi një kohë sterrë  
u mpleksën retë me dhenë  
vetëtimat pezull mbenë  
shkrepën, s'dinë ku të venë.

Pse vepron kështu o Zot  
ti që bëre male, dete  
njerëzit e mirë mbi tokë  
ç'kërkon që i merr për vete?

Pse s'e le shpirtin e tyre  
të na ngrohë, të na mbajë?  
po e rrëmben kaltërsive  
shpirtin tonë të na thajë.

Pse kështu e nuk na thua  
që kur lemë, që kur mbimë?  
po i bën punët e tua  
pa pyetur fare njerëzinë.

Ti e di ç'plagë hape  
në zemër të pashëruar  
na more të mirën Rafte  
kur shtrenjtë e kishim paguar.

2.  
Fytyra të rënuara nga dhimbja  
portrete të vështira për piktorë  
i shoh e ku s'më vete mendja  
tek malet ngarkuar me borë.

Supet nga hallet rregjur  
jetim mbetur që fëmijë  
ndaj luten e s'duan, e s'duan  
t'u ikë një nënë kaq e mirë.

Kjo nënë që zemër behar  
e shtroi sofrën për të gjithë  
kush vajti dhe jetë atje s'ka marrë  
kush iku dhe harroi mirësitë?

I pashpirtë qënka ky shtrat vdekje  
i pagojë dhe preka gojë  
kështu dëshiron të mbetet në jetë të jetëve  
njerëzit i luten ai s'do të dëgjojë.

3.  
Eh, o djem! Të rëndë e keni këtë peshë që mbani  
peshë të tillë s'keni ngritur ndonjëherë  
qerpikët rënduar me se do t'i lani  
me mallin e vreshtave a me varrin e sa çelë?  
Ky shteg i rrëpirë përse shqetësuar?  
Shtrëngon brengë gurësh dhe nuk pyet dot  
mbi supet e tij ç'është gatuar  
e s'ndjen hapa njerëzish, por dete me lot.

Ngashërime burrash dalë thellëse  
porta e drunjtë hapur dykanate  
se ç'kuje do hapje, ti Rafte se dije!  
se ç'kuje do mbante s'e dinte ky prag!

4.  
Këtu janë të gjithë, të gjithë rreth teje  
nxitojnë kontinentesh nëpër botë  
udhëtojnë mbi krahë të reve  
të mbështesin kokën në prehrin e ngrohtë.

Udhëtojnë, udhëtojnë, por dot nuk arrijnë  
dhe ti moj e shtrenjtë, nuk i pret dot  
rrugët e jetës së gjitha u mpinë  
krahët e vdekjes u shtrinë të plotë.

5.  
E ndiej puthjen tënde, o bir  
dhe përkëdheljen e ndiej  
dot nuk të flas se nuk jam mirë  
dhe s'kam më gjak, por mall në dej  
për ku më nise, buzë përpjekur  
me dajon ç'thoni larë lot  
kjo natë që nis më të errur  
mëngjesin për mua se bie dot.

Ky mëngjes dhjetori s'dashka të vijë  
se po të vijë nuk ka ç'të thotë  
supet e ngrira me se t'i shkrijë  
t'u bëj diell lotin e ngrohtë.

Dhe thua:moj nuse s'dal mbi dhe  
dhe le ta harrojnë lindjen time  
të thonë që ai qe  
kur iku nga bote një jetime.

6.  
Për ku udhëton ti Rafte, e di  
të presin Liga, Totua, Golëmja, Alemi  
sa mirë, do ti bëni vitin e ri  
sa keq, që me ne nuk do jeni.

Se ikën një nga një, të gjithë të dhembshuruar  
pa nisur të shihnin ditë të bardhë

nga varret me lule mbuluar  
ngriheni takoheni si më parë.  
Mallin e shuajmë në netë ëndërrimtare  
mblidhemi e bisedojmë me radhë  
harrojmë që kjo botë ka kaq shumë malle  
dhe dot nuk ndahemi të vdekur e të gjallë.

## Më zgjove nga gjumi

Më zgjove nga gjumi  
që kur fërgëllove  
thëllëz' e Golikut  
pa ngritur s'durove.

S'duron dot pa këngë  
ngrihesh që pa gdhirë  
ha inat të vjetër  
me kë bilbil?

Në ke ti inat  
po ç'kusur kam unë?  
bie për të fjetur  
s'më lë të bëj gjumë?

Ngrihem e laj sytë  
te burimi i ftohtë  
herë m'i lan me këngë  
herë m'i lan me lotë.

Herë më afrohe  
këmbë-këmbë pa ndier  
herë më largohe  
dhe më lë të mjerë.

Më zgjove nga gjumi  
thëllëzë e Golikut  
gjumë s'kisha fjetur  
po se paskësh dikur.

## Sevdaja e parë

Lanet paç sevda e parë  
ç'më me atë qepallë  
hëm më do, hëm më do të gjallë.

Ku i gjen lulet e prillit  
që gjezdisin mesit të gjirit  
pleksur si gjerdan floriri  
se mos trembet, s'fryn zefiri.

Po, ku i gjen psherëtimat  
që dalldisin shpirtin tërë  
si vesa që deh lëndinat  
të marrë frymë se lënë.

Po, ku e vjel dritën syri  
që vështron dhe brenda zemrës  
sa e hedh e meket ylli  
sevdalleshë bën dhe hënë.

Ku e gjen prushin që digjet  
si prush'i lisit ngadalë  
japin e se ftohën dotë  
s'gjuhet e djeg si më parë.

## **E bukura Delvinë**

Rrahin valët e Bistricës  
këmbë mali, ballë fushe  
gjithë pellgun e Delvinës  
stolisur, e bënë nuse.

Dëgjohet gërneta  
në brigje, në rrëza  
ç'gëzime ka jeta  
ç'gëzime thotë thëllëza.

Moj e bukur Delvinë  
derdhur shtati gjithë lule  
të mirë fëmijë që rrite  
djemtë trima, vajzat nure.

Mes qytetit lapidari  
ngritur si një malë me dritë  
kur për bijtë të merr malli  
vete pranë e puth sytë.

## **Dëshmorëve të Hormovës**

Shumë këngë kemi ngritur  
dhe të tjera do të ngremë  
gjithë nderimet e kombit  
në rrënjë të këngëve do vëmë.

O Luto Caka me shokë  
Shqipen dhe Hasan Velinë  
Hurmanë dhe Rahim Camën  
Nevron dhe Sefedin.

Abazin dhe Ramo Dinë  
nëntë yje për liri.

Nëntë yje, nëntë lastarë  
nëntë vetëtima mali  
nëntë emra në lapidarë  
nëntë zemra si stërralli.

## **Gjeta një thëllëzë**

U ngrita pa gdhirë  
mora shtegun lart  
gjeta një thëllëzë  
këngës ia kish marrë.



Desha që t'i flisja  
pse s'i fola vallë  
qerpikun e syrit  
vesa ia kish larë.

Desha që ta ngisja  
ç'nur që i kish rënë  
nuri i nusërisë  
larë me borë e hënë.

Lulet e qershisë  
rënë përmbi flokë  
desha të marr njërën  
po s'e mora dot.

## Poetëve

Kamë shumë shokë, poetë të nderuar  
me ta, sa herë poezi kemi pirë  
me ta, sa herë kemi ëndërruar  
shpresë jete, fluturim në hapësirë.

Poetët, kudo që janë në botë  
shpirt të butë e të ëmbël kanë  
kush për poetët një fjalë më thotë  
vargun tim do ta bëj kamë.

Në këngën e tyre, do doja të isha  
kështu si jam i varfër, i thjesht  
veç zjarrin e zemrës së tyre të kisha  
dhe dhembshurinë që ka një poet.

Në zjarrin e tyre do digjia poshtërinë  
me zjarrin e tyre do digjia gjithçka  
gjithçka, që me farë të keqe ka mbirë  
dhe do të mbillja kohë të mëdha.

Poetët janë epika kombesh  
mimoza që çelin në pranverë të vështirë  
jo tregtarë cikërimash, furgonësh  
po engjëj të vërtetë, njerëz të mirë.

## U ul poshtë një degë bliri

Moj thëllëza kaçullatë, pse s'më prite  
xixëllonja nëpër natë, pse më ike.

Unë doja, lule molle  
të thosha një fjalë goje  
edhe ti të më dëgjoje.

U bë vonë, zuri nata, ndaj s'qëndrova  
mblodha veç një krah me shkarpa, dhe nxitova.

O djalë që më rri pranë  
mos ma mbaj kokën mënjanë  
do vijë prapë e do marr malë.

Kur hënë e bukur të nxjerrë, vetëm synë  
do marr culën do t'i bie, në lëndinë.

Merr, moj hënë me dritën tënde  
avazet e kësaj kënge  
shpërndaji mbrëmje për kënge.

Po, ç'e do dhe hënë, kur do t'më kesh mua pranë  
ato që do thoshe, vallë pse s'i thua.

Mos u hidh degë më degë  
se sevdaja të fletë vetë  
zemra, zemrën kur e pret.

Zemra-zemrën, syri-syrit, i thotë shumë  
u ul poshtë një degë bliri, përmbi buzë.

Zgjatu e këput një lule  
në buzë të mia vure  
aromë fushe më prure.

## **Një bilbil që rri në portë**

Një bilbil , që rri në portë  
thotë e ç'nuk thotë  
thotë këngë plotë  
nuk i mbaron dot  
bilbili që rri në portë.  
Luan me një borzilok  
i mjeri, që lodhet kotë.  
Lodhet kotë bilbil i mjerë  
borziloku ka të tjerë  
borziloku do një tjetër  
bilbilit këngët i mbetën.

## **Një trim që mbeti në borë**

Një trim që mbeti në borë  
zë e flet me një shqiponjë.  
Aman në më vafsh në Vlorë  
të m'i thuash nënës korbë  
mua të mos më kërkojë.

## **O djemtë tanë të mirë**

O djemtë tanë të mirë!  
ç'keni që u hyri smirë  
dhe s'vështroni Shqipërinë  
që hallet e kanë mpirë.

Ç'keni që nuk rrini pranë  
si vëllai me vëllanë  
si zogj, që një fole kanë  
pse kështu kamë më kamë?

Nga të tjerë keni parë  
vetëm thika e hanxharë  
shekujve, çarë e përçarë  
s'donin të na mbetej farë.

Kishim baballarë trima  
që thyenin suferina  
hasmit bërë pritë prima  
i futën si minj në vrima.

Ndaj nuk humbëm, ja tek jemi  
e kishim flori mademi  
vdekja mjaltë, kur ramë për vendin  
nuk e harron gurra shkëmbin.

Që të jemi jetë e motë  
mblidhuni të gjithë tok  
s'çahet vetëm nëpër botë  
sup më sup, vendi ka zot.

Më thonë në Shqipëri  
birit i flasin bilbil  
ç'është ai që nuk e di  
këngën që këndon në prill.

Kur këndon bilbili këngë  
të gjithë zogjtë pushojnë  
le qyqet që bien gjëmë  
nuk dinë nga të shkojnë.

Më dhembka gjaku kaq shumë  
më dhembka në dhe të huaj  
i pa emër, i pa punë  
paskam lindur që të vuaj.

S'jam i vetëm, ka si unë  
qindra mijra nëpër botë  
pjekur malli për Shqipërinë  
për tokën tonë të ngrohtë.

## **Kosova**

M'u qiell syri i tërë  
re të zeza u ngarkua  
me gjëmimin aq të rëndë  
derdhi lotët përdua.

Si përdua derdhet loti  
mbledhur, hedhur nëpër shekuj  
eshkë i bëhet barutit  
të ndizet si herë tjetër.

Të ndizet, të flakërojë  
me rrënjë hasmin ta shkulë  
që paqja të mbretërojë  
me gjak të vërë atë vulë.

Ajo vulë s'thahet kurrë  
se merr gjak nga ai gji  
Kosovë që ngre flamurë  
na mbledh të gjithëve aty.

Na mbledh rrotull vatrës tënde  
që gjithnjë mbeti e ngrohtë  
barra e rëndë serbe  
se ftohin e se ftohin dot.

2.

Një vargan i gjatë në vite  
i ngurrosur, i kreshpëruar  
i tregon Evropës dhimbjet  
i gjakosur, i varrosur.

Buzëpërgjakur me lot  
i therin supet, i therin  
ka derte, nuk i thotë dot  
s'ia tregon dot fjala dertin.

Sa shumë murana mbrapa ka lënë  
Kosovën, të stërmadhe muranë  
të mblidheshin arkivolët të tërë  
dherat e globit dot s'i mbajnë.

Kosova i mbajti brenda vetes  
dhe djepe nanuriste nëpër netë  
erë ironie frynte shtetesh  
ajo thërmonnte shpirtin, në vatrën e nxehtë.

Shkërmoqte shpuzën e shpirtit të saj  
dhe shkëndijat flakëronin kufijve  
meteorë të tillë. nuk ishin parë  
t'u ndrisnin udhën Perëndive.

Fundshekulli i lodhur nga luftrat  
në qefinin e tij kullon gjak  
me kurriz të dorës fërkon rrudhat  
brazuar aq thellë në kafkë.

I padrejtë, si nisi s'do të iki  
koka politikanësh mblodhi në gji  
në Kosovë radhët fort i shtërngoi fisi  
balli i horizontit mbrunte stuhi.

Lubia në z'gafella historie  
vërtiste jataganin shkullor  
lisave s'u mbetej kohë për hije  
maleve s'u mbetej kohë për borë.

Fushat u bënë një me djepet  
nanurisinin bukën për martir  
që Evropa gabimet të ndreqte  
nuk futej në vargan viti dymijë. . .

3.

M'u qiell syri i tërë  
re të zeza u ngarkuan  
me gjëmim aq të rëndë  
derdhi lotët si përrua.

U derdh loti ku pikoi  
ku gjeti , shtratin vallë  
në atë dhe , që qysh që moti  
gjaku i derdhur nuk është tharë.

N'atë dhe, që plagë e shpatës  
dregëz nuk i zuri kurrë  
n'atë dhe që terri i natës  
kot u lidh , se zuri gjumë.

Në atë dhe, ku gratë linden  
dhe në vdekje, përtej varrit  
në atë dhe, ku burrat s'ikin  
po nuk morën plumbin ballit.

Në atë dhe ku, s'njihet loti  
vetëm këng'e trimërisë

shkërmoqet në gji baroti  
dhe pikon qumësht në sisë.

Në atë tokë, ku dhjetra shekuj  
shkojnë gjuhën se ndërroi  
hënë jashtë me ne është pjekur  
qën e nisi, mi mbaroi. .

Ku të vejë Millosheviçi  
shpirt'i tij dhe krimi një  
Kosova fitoi liri  
me gjakun e kuq që dhanë djemtë për të.

## **Mars 97**

U këput e s'doli hëna  
atë Mars aq të vrarë  
u mbush qielli me rrëmbe  
u bë dheu palë-palë.

Deti vetullat shtëllungë  
përmbi ballin i mbërthen  
majë e dallgës s'theu shkumë  
flakë vetëtime theu.

Thinjë e malit u derdh poshtë  
brenda natës si rrëke  
nga ullishtat ikën zogjtë  
heshtje varri si atje.

Vlora syrin derdh Sazanit  
dhe Sazani më përtej  
brigjet fqinjë zunë të qarin  
vinte kuja përkëtej.

Vinte kujë, vinte gjëmë  
që s'qe parë ndonjëherë  
thante lulet që në rrënjë  
linte vitin pa pranverë.

## **Nëpër viset ku kam shkuar**

Nëpër viset ku kamë shkuar  
vera më erdhi e lehtë  
vjeshta, gjethet pa zverdhur  
dimri, ç'erdhi aq i nxehtë.

Vera burimet i thante  
dhe gurët i përvëlonte  
copë-copë më dysh i ndante  
si të ikte nuk duronte.

Vjeshte më vinte veronjë  
shterponte e pamësuar  
nuk e pashë njëherë lehonë  
në këta dhera të huaj.

I acartë vinte dimri  
dhe shpirtin borë ma bënte  
thosha, pse nuk ikte viti  
pranvera a do më gjente.

Vallë do vinte pranverë  
te terreshin lotët tanë  
të qeshte buza njëherë  
të ç'malleshim me vatanë.

Ç'ke pranverë  
që s'dukesh në horizonte?  
jemi kaq të dhembshuruar  
na mbledh vetëm sofrë jote.

## **Pritja**

Në klithmën e parë të jetës  
pret qumështin jetëdhënës  
në frymëmarrjen e fundit  
trokitjen e lodhur të zemrës.

Midis këtyre kufijve  
miliona pritje ka  
pritje të mërzitshme  
po dhe gëzimemëdha.

Pritja dhe njeriu  
kurrë s'ndahen dot  
se ai që nuk pret  
nuk është në këtë botë.

Ndaj dhe unë pres  
pres e s'lodhem fare  
të bëhet më e mirë  
kjo jetë mëkatare.

Të bëhet më e bukur  
si emri që mba  
nëse s'do të bëhet  
pritja, ç'kuptim ka.

## **Zemra pikon derte**

Zemra pikon derte  
syri lotin thanë  
dhimbja për kurbete  
malli për vatan.  
gjiri i nënës tharë  
djegur, përvëlur  
që në djepe tretur  
në dhera të huaj.

## Në kohën e parë

Në kohën e parë  
të prisje një ulli  
burgun kishe qarë  
dhe turpin si ti.

Thonë Skënderbeu  
kudo që martonte  
njëzet rrënjë ullinj  
të mbillte kërkonte.

Dhe mbusheshin kodrat  
plot me gjelbërime  
rinin përmbi fusha  
kurorë dafine.

Po tani ç'na gjeti  
që morëm sëpatën  
nuk na doli dita  
po lodhëm dhe natën.

Dhe e mbushëm vendin  
plotë për plotë me cungje  
sikur gjithë sakatët  
këtu vijnë e ngulen.

Në kohën e parë  
i shenjtë qe ulliri  
po përse e prisni?  
keni mënd a s'kini?

## Mbi syrin e shkruar

Mbi syrin e shkruar  
derdha gjithë vështrimet  
kush të kish ngacmuar  
manushaqe prilli?

Pse t'u drodh qerpiku  
vetulla harkuar  
trëndafilin i bukur  
të mbeti në duar.

T'i mbuloi faqet  
të kuqet e mollës  
sytë m'i verbove  
me shkëlqim të borës.

Si s'më the njëherë  
o djalë të dua  
mendja mu bë erë  
nga nazet e tua.

Për një fjalë tënden  
malli më kish marë  
kur u dashkan zemrat  
folkan dhe pa fjalë.

Zgjate atë dorë  
më dhe trëndafilin  
mbi një degë mollë  
ia mor bilbili.

## **Të kem zërin e bilbilit**

Dua, si nuk dua  
të kem zë bilbili  
për këngët e tua  
kur të vijë prilli.

Dua, si nuk dua  
plot lule behari  
t'i mbledhësh me mua  
kur të vijë maji.

Dua, si nuk dua  
të rrahë kraharori  
nga nazet e tua  
kur të vijë qershori.

Dua, si nuk dua  
të të shoh qerpikun  
larë me ujë burimi  
në vapë të korrikut.

Dua, si nuk dua  
të isha si rrushi  
për buzët e tua  
kur të vijë gushti.

Dua, si nuk dua  
të vemi në festa  
krah për krah me mua  
kur të vijë vjeshta.

Dua, ç' nuk dua  
të kuqosh si molla  
kur të vijë dimri  
kur të bjerë bora.

## **Fletë larë diell e vesë**

Karafil i kuq me erë  
ç'më mbulove penxherenë  
shkojnë djemtë e fërshëllejnë  
sytë ç'u mbetën këtej.  
Karafil i kuq me gonxhe  
lulja që s'të gjendet shoqe  
fletë larë diell e vesë  
gjithë lezeti i baxhesë.  
Pa rritu, rritu dhe pak  
pa ardhur era me vapë  
rritu e lësho lastar  
lule bukur për beqar  
more karafil.

## **Shokë të na vejë kënga**

Shokë të na vejë kënga  
zemër-o  
Se kemi halle të rënda  
zemër-o.



Se kemi ikur nga rrënja  
zemër-o.  
Na kullon e çahet zemra  
zemër-o.  
Nuk e di ku na ka nëna  
zemër-o.  
Piqemi natën me ëndrra  
zemër-o.

## **Netët e refugjatit**

Netët mezi gdhihen  
ditët mezi vijjnë  
në ëndrrat e mia  
ankthet ulur rrinë.

Në ëndrrat e mia  
frika mos më zërë  
se vjen policia  
të shkon në gjilpërë.

Bie rrobaveshur  
dhe nuk shoh më hënë  
nuk ka më të qeshur  
nuk ka më dhe këngë.

Më bëhet në zemër  
një xhëng aq i rëndë  
dua ta çaj ëndrrën  
të flasë me të tërë.

Shpërthej në gulçime  
dhe dalldis në këmbë  
ja tek vendi ynë  
ja plas bota shtremë.

## **T'u tret syri valëve**

Ç'pret, moj ç'pret, që t'u tret syri  
t'u tret valëve mbi det  
pret dimrit kur fryn thëllimi  
varës kur djeg vapë e nxehtë.

Buzëplatur nga mjerimi  
burrë mbetur në kurbet  
i thua ligjet e gjirit  
dhe me mall, dhe me dert.

Pikon gjetheve t'ullirit  
loti që faqeve zbret  
bie mbi ballin e birit  
babëprituri në jetë.

Valë, moj e kaltra valë  
sa nëna mbetur pa djalë  
sa nuse nuk veshën pajë  
sa djepë nuk njohën babë,

Valë, moj e bukur valë  
ç'jetë e bukur na ka ardhë  
si shkuma jote e bardhë  
si drita që mbush beharë.

## Ç'është dashuria

Ç'është dashuria?  
ai zjarr që mban rinia  
prushi që mban pleqëria  
në shpuzë të saj të bija.

N'atë shpuzë, kush s'u poq  
n'atë shpuzë, kush s'u dogj  
i zuri në grackë si zogj.

Ç'është dashuria?  
pyetni kë ka dashuruar  
nëpër mëngën e saj  
rrallë mbeten pa kaluar.

## Ndarja

Ike natën pa hënë  
ike përmbi dete  
s'mendove për mua  
s'mendove për vete.

Sy më sy u pamë  
dhe të dy s'guxuam  
të thoshim një fjalë  
lotët i kaptuam.

Dorës që më dridhej  
të vura në dorë  
zemra zuri hidhej  
syri hidhte borë.

Kokën e mbështeta  
në gji tënd ngadalë  
m'u duk sikur fjeta  
s'isha më e gjallë.

Ngashërima jote  
përvëlonte ballin  
e dija ç'më thoshte  
se ia dija hallin.

Dhe ashtu u ndamë  
në një natë sterë  
ty s'të gjetën varrë  
unë rrobazezë.

## Vjen kënga

Kënga që më zgjon nga gjumi  
më vjen si pëllumbi

Aman, ik këngë të thashë  
kam fjetur mbi vesë jashtë  
përmbi vesë, ndënë hënë  
se meraku më ka zënë.

Vjen e ulet mbi qepallë  
sikur do më marrë  
vjen e çlodhet përmbi faqe  
trëndafili në bahçe.

Vjen e puthemi në buzë  
dhe më ndeze gjirin shpuzë.

## **Kërkova vargje për këngë**

Kërkova vargje për këngë  
gjeta gjithë refugjatë  
nga një varg erdhën ma bënë  
pikur lot e mpiksur gjak.

Mallin që zhurit gjinë  
si mal të lartë më dhanë  
mjerë zemrat ç'derte pinë  
mjerë supet ç'halle mbajnë.

Vetëtima që çan retë  
bën stërrallin copë-copë  
pa ato djepet ku lemë  
na presin t'u vemi prapë.

Të puthim varret e parë  
ato varre aq të rëndë  
t'u themi që jemi pranë  
jo me vajë po me këngë.

## **Udhë të mbarë, zëri ynë**

Rrëmbeva penën në rilindjen tënde  
në shpirtin e të ikurve e ngjeva me lot  
dhe thashë, sokaket e thinjur nuk paskan mendje  
a unë mendjethinjur s'i kuptokam dot.

Dhe shtrydha mendjen këtë natë prilli  
bishtin e cigarit thërmova me dhëmbë  
vëllezër e motra, dua të më vini  
për një ditëlindje të marrim një këngë.

Të marrim një këngë dhe të qajmë halle  
se kënga me halle është gatuar  
dhe vetë Zoti mori një magje  
bëri dhe male dhe dete të shtruar.

Dhe malet e detet e kemi brenda gjirit  
ndaj dalgëzujmë e peshojmë rëndë  
se nuk përfillim karatin e floririt  
karati ynë është një Nënë.

Udhë e mbarë, zëri ynë  
"zëri i emigrantit" me shpresë  
kur të kemi bërë Shqipërinë  
zëri im le të vdesë.

## Shqipërisë

Bota loz e qesh  
po nëna ime pse jo?!  
tjetër gjak u desh  
po kush derdhi sa ajo.

Shekulli në djep  
ende pa lerë lëngon  
pse s'mbytet në det  
lumej gjaku si duron?

Historia fletë  
kujt i shkelëm në kufi?  
kocka na u tret  
tek i thonë Shqipëri.

Shqipja fluturon  
krahëplagosur nëpër re  
ç'ilaç e mjekon  
veç bashkimit të trojeve?

## Zog furtune mbi det të egërsuar

"Arvanitasit të madh, Aristidh Kolja"

Zërin tënd, mërgatë Shqiptare  
në pentagrame të kohës e dëgjon  
si muzikë e ëmbël cicërimtare  
që shpirtin e vrrarë na qeton.

si zog furtune, mbi dete të egërsuar  
fluturon e s'ndalet ngadhënjimtar  
detet nuk i ngrenë dot ballët e tua  
dhe heshtin uraganët gjëmimrrallë.

Shkulmet e lotit mbi varin tënd  
rrokullisen, burojnë pasosur  
mbrëmjeve vjen e të bën kuvend  
shqiponja e maleve plagosur.

krahët i hap, në gji të mbështjell  
mëmë e bir nga malli i pikur  
mëngjesi që vjen ashtu e gjen  
fluturon synjomur mbrëmjen për të pritur.

Thuren legjenda, këndohen këngë  
gojë më gojë, jehonë pas jehone  
ti, burri i madh që peshove rëndë  
çlodhesh tani në krahë shqiponje.

## Vdekja e samarxhiut

U vesh fshati gjithë zi  
se vdiq samarxhiu  
ish punuar si ai  
një jetë njeriu.

Gjithë jetën i mjeruar  
në një strehëz jashtë  
mbirë sqepari në duar  
fjetur përmbi kashtë.

U hap lajmi anembanë  
dhe mbuloi dhenë  
gjithë gjindja vunë vajnë  
dhe zogjtë në pemë.

Dhe vetëm gomarëria  
u hoqën mënjan  
thanë që ndodhi çudia  
mbetëm pa samarë.

Bredhërinë në lëndinë  
dhe zunë të pallin  
kurrizin për dheu shtrinë  
siç zhgëryhet gomari.

Veç një plak nga soji i tyre  
u mbyt vaji i shkreti  
iu qasnë ajkë e të rinjve  
e pyetën: Ç'të gjeti?

Qaj për samarxhin e vjetër  
që masën na dinte  
nesër do vijë një tjetër  
një djalë njomishte.

Do verë dhogat siç janë  
ashtu pa latuar  
do bëhet kurrizi plagë  
do ngordhim ngarkuar.

Varën kokën, ulën veshët  
të zestë gomerë  
kërkuan e dot s'e gjetën  
samarxhinë e parë.

## Udhëtojnë arkivolët

Arkivolë të kuq udhëtojnë  
drejt veriut, arkivolë-gjak  
mbi dhoga plagë plumbash rëndojnë  
arsyeja mbërthehet me llak.

Arsyeja burgoset në qeli racizmi  
të zeza janë më keq se ferri  
pashallarë bëhen satanai e vampirë  
sa habitet dhe Dante Aligeri.

Në botën moderne të fillimshkullit  
duartrokitën vrasës mesjetarë  
demokracia pudroset me servilizmin e shtetit  
ndërsa arkivolët shumohen, shkojnë radhë.

Të akuzonin dot arkivolët të tërë  
arkivolët-gjak, që ikin për në veri  
për vrasësit s'do të kishte vrimë të hyjnë  
në gjyqe s'do të kish kadi.

## Buza si prush karafil

Mano, ç'të thoshte bandilli  
manushaqe moj Mano  
të ndizej zjarri te gjiri  
buza si prush karafili  
syri të londron tek ylli.  
Mano kur merrje sokakun  
u shtojë djemve merakun  
s'i lije të flinin gjumë  
të ndiqnin gjurmë më gjurmë.  
Mano, pa gdhirë mirë  
dilje stolisje avllinë  
të ngisnin me fërshëllimë  
ti lozje me trëndelinë.

## Këngë për Nimete Progonatin

Ç'është kjo festë kaq e madhe?  
gjihapur kë pret moj nënë?  
njëzet e gjashtë korriku  
gjithë lulet bëri këngë.

I bëri këngë trimërie  
pikoi gjakun e bijve  
gjakun e derdhur nëpër vite  
rrënjë lirie.

O ju zogj, shqipet e malit  
ju që jua njoh shkreptimën  
mblidhuni, shuamëni mallin  
për Nimete heroinën.

Ai trupi i saj i brishtë  
sup mësuar me dyfekun  
nga Luzati gjer në Sinjë  
vallë ç'hasmi s'i zu shtegu?

Ç'të tha vallë Shefqet Peçi  
ai komandant i rrallë  
mos, moj mos, motër Nimete  
mos i dil sulmit në ballë.

Mos, moj mos, ti s'e dëgjove  
ku të mori plumbi vallë?  
tek merr trimat në llogore  
dhe në zemër, dhe në ballë!

## Nuk paska jetë pa varre

U këput gjethja në vjeshtë  
dhe mori të tatëpjetë  
e përkundi fladi lehtë  
e përcjell në tjetër jetë.

Syth i njomë çikëloi  
vate prilli, maji shkoi  
beharin e beharoi  
po gushti e përvëloi.

Dhe iku buzëzhuritur  
borën e parë pa pritur  
theu supet duke rënë  
dhe rënkoj: Ah, o nënë!

Pema -nënë e dëgjoj  
derdhi syrin e vështroi  
piku zemrën, nuk duroi  
një lot mbi gjethe pikoi.

U tretën në dhe të lashtë  
dhe loti, dhe gjethja bashkë  
pema dimërimin shtynte  
dinte pranvera do vinte.

Dhe do çelte gjethe tjetër  
po s'harron gjethen e vjetër  
ç'qënka kjo botë xanxare  
nuk paska jetë pa varre.

## **Kalaja e Tepelenës**

Me dorë të dridhur fërkoj muret e kalasë  
e stërlashtë është kalaja ime  
po më duket sikur kemi lindur të dy bashkë  
si gjalmi në boshtë me tjetër kujtime.

Damarët e saj më ngjiten me damarë  
dhe brenda tyre vrushkullon gjak i shenjtë  
se nga një rrënjë e kemi marrë  
dhe nga një rrënjë mbijnë të gjithë.

Dhimbjet e kohës asaj ia lashë  
dhe vetullmbërthyer i duron  
edhe pse nuk jam Ali Pashë  
del nëpër netë e më kërkon.

Në supe të saj veniten jetë  
të tjera çikëlojnë si engjëj në qiell  
unë udhën do marr për në të vërtetë  
ajo, këmbët në Vjosë, ballin në diell.

## **Ruajna Zot. . . . .**

Anës lumit, anës-o  
buzës gjolit  
vargje-vargje vashat-o  
ligjëronin.

Hëna ktheu syrin-o  
të ndriçonte  
vesa preu udhën-o  
dhe s'vesonte.

Zogjtë hapën portat-o  
të përgjonin  
lulet hapën gonxhet-o  
të dëgjonin.

Foli e para në to  
ngashërime  
kërkonte qiellit-o  
perëndime.

Lutej, lutej si ajo  
derdhte derte  
Zot ruajna trimat-o  
në kurbete.

## Shqipja shtrenjtë e pagoi

Iku prilli, mori maji  
rrokullimë  
lulet vyshken, thahet bari  
në lëndinë.

S'vjen behari, s'kanë krojet  
gurgullimë  
vitit copra thërrmohet  
nuk ka stinë.

Bora malet i ngarkoi  
detet ngrinë  
gurra djemtë i kulloi  
në borimë.

I kërkon e përgjërohet  
dot s'i vijnë  
nëpër dyer të gjitonëve  
lotët pijnë.

Pijmë lotin e rrëmbyeshëm  
ngashërimë  
të bukur lisa këpute  
suferinë.

U çmend koha e harroi  
më për stinë  
shqipja shtrenjtë e pagoi  
me rininë.

## Vargjet për Milloshin

Si afsh i mallit më erdhe në penë  
mbështjellë me dhëmbshuri prindërore  
gurët e kalldrëmeve rënkoni thellë  
kur shkoje me Agronin për dore.

U këputeshin rënkimet, sikur shkonin shekuj  
vapës së Koplikut, dimrit të acartë  
ty djersa e ballit të kishte mbetur  
si aureale e stërlodhjes së gjatë.

Bëje sikur flije, sikur zgjoheshe  
se ti as fjete, as u zgjove ndonjëherë  
vështronte dhimbshëm fytyrat e fëmijëve  
që cicëronin si zogjtë në pemë.



Diçka mërmërisje, askush se dëgjonte  
veç Zoti dhe një varrë atje tej  
tek ishte tretur dashuria jote  
tek pikonte loti fshehtas nëpër terr.

Se lotin ti kurrë se tregove  
ballin mbështesje te samari i hamallit  
dhimbjet e shpinës dije t'i duroje  
po nuk u duroka dhimbje e hallit  
dhe ike, u drodhën gurët e kalldrëmeve  
dhe njerëzit u gurëzuan  
nuk kishte ndodhur ne varrime  
njerëz e gurë lotë thërmuan.

## Gjirin hap moj Vlorë

Gjirin hap moj Vlorë  
lotin bëj liman  
se një det i vetëm  
dhimbjet dot se mban.

Malet kokë më kokë  
u shkrehën në vaj  
ai dhe i ftohtë  
gjëmën si do ta mbaj.

M'u plake moj Vlorë  
vetëm për një ditë  
s'ke rroba të zeza  
t'i veshësh të gjithë.

Si duron o luçë  
dhe s'të çahet zemra  
si ishin burbuqe  
pse tu thahej rrënja.

Amanet o qiell  
gjithë shpirtin e tyre  
bëj të bjerrë diell  
të mos mbyllen dyer.

Bëj të mbijnë këngë  
te kjo tokë e gjakur  
të harrojmë ç'bëmë  
të ndërtojmë pragun.

## Bëj durim

Detet kujë, malet gjëmë  
bëj durim e mira nënë  
bëj durim e shtrenjta zonjë  
dhe në varrë të flasim zonjë.  
Djepet më tundën të rëndë  
mbushur lotë e tretur këngë  
bota supet ngre përpjetë  
si i rriten Shqipës djemtë.  
Ngjitur si lisa për shkrepi  
dot si sosi dhe kurbeti  
mbërthyer rrënja për guri  
si shqiponja për flamuri.

## I ikur pa adresë

Ike dhe s'u ktheve kurrë  
siç ikin vitet e s'vijne  
thërmon zaje, shkërmoq drurë  
guri kur merr rrokullime.

U nise udhë pa udhë  
bie shiu të bën ujë  
dilte dielli të thante  
binte vesa e të lante.

Vesëlarë, dielltharë  
qefinin me vete marrë  
mallkim dhënë Perëndisë  
që s'i sheh njëlloj të gjithë.

Të kërkuan, nuk të gjetën  
pyetën male, dete pyetën  
pyetën Zotin, s'dha përgjigje  
pyetën zogjtë, thanë ligje.

Nëna s'u vesh në të zeza  
se e mban e shkreta shpresë  
mos trokasë penxheresë  
i ikuri pa adresë.

## Vajzë e valëve

Vajzë e valëve që pret  
mbi një gur anës së detit  
s'ngrihem dot që të vi vetë  
mos ma nis djalin kurbetit.

Zemër përvëluar  
dashuri e shuar  
lot i pambaruar  
këngë e paharuar.

Vajzë e valëve legjendë  
sa vasha si ti na mbenë.

Ngrije moj gurin e varrit  
të të shoh syrin njëherë  
jo moj jo s'kam ç'i bëj djalit  
do vijë babanë të gjejë.

Është i rëndë guri i varrit  
se është guri i dheut të huaj  
po të qe guri vatanit  
do vija në gjirin tuaj.

Malli mbledhur nëpër vite  
do të bjer' në tokën mëmë  
presin zemrat që zhurite  
edhe gjëma bëhet këngë.

## Pik'e lotit lag fustanë

Qerpiku i diellit pa dalë  
dallëndyshet lartë në mal  
vashës i thonë ca fjalë  
pik'e lotit lag fustanë.

T'erdh karta për nizam  
dridhet buza hanë ciagarë  
në u kthefsha dot i gjallë  
dil më prit te gur i bardhë.

Kaluan kaqë beharë  
mbeta me kokën mënjanë  
kur u poqëm s'di ç'ka ngjarë  
vesa lag e ne prapë të tharë.

Kur të dy hipën mbi kalë  
shkundën lule zogjtë mbi dardhë  
mjegulla mbuloi dynjanë  
bilbilat ndezën sabanë.

## Vitet që shkuan

Për ato vitet që shkuan  
m'u bë gjiri rrushkullimë  
ikën ashtu pa kuptuar  
si nata në mugëllirë.

Ikën e gjurmët i lanë  
përmbi supet e kërrusur  
mbi flokët bora sa rarë  
mbi rudhat tek balli futur.

Bastun më bëhet për dore  
nëpër shtigjet hallelarë  
ecim e s'ndjekemi lodhje  
me hapin ritëm si ushtarë.

Dhe mbi botë bashkë shkelim  
me të rëndin trokëllim  
agimeve dritën vjelim  
mbrëmjeve tersin e pimë.

Dhe keshtu, por deri kur  
unë dhe vitet se dimë  
veç po ikëm s'vijmë kurrë  
se nuk ikim që të vijmë.

## Poeti, politikani dhe ustai

Mëngjesesh, poeti  
për zakon të vjetër  
dilte poshtë qytetit  
përshëndeste jetën.

Karrigen në klub  
askush nuk e zinte  
e dinte ustai  
që ai do vinte.

Dhe hynte ngadalë  
ashtu pa dëguar  
me gjirin të valë  
me fjalën të shtruar.

Dhe merrte poeti  
një gotë rakie  
herë me para  
herë veresie.

Një politikan  
qeshte ndënë mustaqe  
si putanë rrugësh  
i kuqonin faqet.

Dhe bënte gallatë  
pinte pa para  
lëre-thoshë poetin  
se aq mëndje ka.

2.

Kot nuk tha i pari  
që një burrë vlen  
aq sa i ka xhepi  
okë e derhem.

Pa më shihni mua  
për një fjalë që them  
i këput milionat  
dhe pse jam legen.

Shih si rri poeti  
i vetëm kërcu  
shih sa kamë unë rrotull  
dhe sa s'janë ketu.

Lëre, mor i shkretë  
lëre poezinë  
shtirje atë dorë  
dhe kërko mëshirë.

Poeti shtërngonte  
pallton rrakëzërë  
nga inati gishti  
hapi dhe një birrë.

Përtypte cigarin  
e brente me dhëmbë  
brenda gjirit tij  
dallga vjen e rëndë.

3.

Brenda gjirit tij  
gatuhej epoka  
nuk gjykonte xhepi  
po gjykonte koka.

Dhe qeshi njëherë  
siç qeshin poetët  
sill-i tha ustait  
dhe një gotë tjetër.

Pije-tha ustai  
një gotë nga unë  
pa politikanët  
një qumësht, dy ujë.

Se politikani  
vetë të mos vijë

kurse bima jote  
rrënjaset të mbijë.

Rrënjaset të mbijë  
dhe ngulet te rrapi  
dimrit-suferinë  
verës-mjaltë, mjalti.

Poeti nuk foli  
s'kish gjë për të thënë  
kaptoi një gotë  
dhe gdhendi një këngë.

## Shpirti i bardhë

Nga ëndrra të frikshme u zgjova këtë natë  
Shtriga hundëshpifura, vampirë dhëmbëshpatë  
më zbërthejnë brinjët, i kripin me gjak  
më shkërmoqin gjirin e kthehen prapë.

Me tymnajë magjie, me ankthe padurimi  
falanga ndëshkuese mbi kokë me rinin  
si të babëzitur buzët i lëpinin  
nuk u dilte gjaku, shpirtin të më pinin.

Mjekrat lerosur me jargë të poshtërsisë  
nën rrasë inkuizicioni, thikat e pabesisë  
histerike ulërinin nëpër natën pise  
shpirti të m'i jepnin ngjyrën e mërzisë.

Dhe u revoltua shpirti i munduar  
dy këlyshë bushtre i mblodhi në dorë  
mbi shkëmb të kohës i plasi me forcë  
dhe mbeti siç ishte, i bardhë si borë.

## Na dogji malli o djem

Shkojnë vitet e ju pranë  
na dogji malli o djem  
o djem që u rrit nëna  
për ditë e halle të rënda.  
Gjaku që rrodhi nga gjiri  
hodhi themele floriri  
lule o ju djemtë tanë  
krah për krah me komisarë.  
Me fishek mbushur gjerdanë  
shkruat me gjak e pope  
pranë lapidare  
28 mijë me radhë  
ratë për një botë të re  
midis nesh jeni të gjallë  
lule djemtë e nënave.

## Këngë kurbeti

Zemër-o piko gjak e lotë  
mbetur-djemtë nëpër botë  
tretur-o kamzhiku mbi kokë  
futur-o thellë ndënë tokë  
hedhur-o tek pëlçet dhe guri.

Ah nëno, ç'heq e vuan burri!  
digju-o si prush krahërori  
o biro, po ç'vapor të mori!  
varur-o dyfeku te muri  
pritur-o kurbetllinë që humbi.

## **Një nga ne, bëhet një mijë**

Bajrami me Hito Labin  
urdhër nga Çerçizi muarr  
te qafa ndënë pazar  
dy, tri kobure gjëmuan,

Ato kobure të rënda  
kishin gjithë malet brenda  
kishin shekuj robërie  
kishin zjarr e flakë lirie.

Bimbashi nga Anadulli  
kish harruar atë ditë  
se shqipes s'i dridhet dora  
po e preke dot një çikë.

Kish harruar ato kohë  
kur bimbashë e pashallarë  
me sulltan Murat Turqinë  
ikën me bishtin në shalë.

Se ky truall kishte brenda  
më shumë krisma se gurë  
hoqëm plot halle të rënda  
po se shtrimë dorën kurrë.

Ndaj kur derdhemi mbi hasmin  
një nga ne bëhet një mijë  
ja rrojmë me nder mbi tokë  
ja nuk rrojmë pa liri.

## **Ç'ke moj buzë që dridhe**

Ç'ke moj buzë që dridhe  
këngës pse s'ia merr  
ditë e muaj shkojnë  
malli nuk na shter.

O deti me dallgë  
mali gjer në re  
fjala jote shpatë  
jeta për atdhe.

Nëpër vite lufte  
për nder e lavdi  
e mbajte të kuqe  
nënë Shqipëri.

Na ka marrë malli  
s'të harrojmë kurrë  
hedhim sytë e shohim  
të kuqin flamur.

## Një zemër po troket

Një zemër po troket  
një këngë në gji buçet  
një pulëbardhë mbi detin vallëzon  
dhe mbrëmja ëmbël zbret  
djaloshi vashën pret  
me buzëqeshjen mbrëmjen ledhaton.

Çel, ti dashuri  
si gonxhe në pranverë  
mes nesh gjithnjë vezullo  
si dritë në sy  
na ndriço përherë  
në qiellin e kaltër fluturo.

Një zemër po troket  
një këngë në gji buçet  
një pulëbardhë mbi detin vallëzon  
në valë përplaslet lehtë  
zemra-zemrës i flet  
veç pulëbardha zemrat i dëgjon.

## Fshatit

Fshati im i bukur  
un' u plaka ti i ri  
ditën dhe natën në gjumë  
mendjen e kam gjithmonë tek ti.

Kudo vajta dhe luftova  
ngado shkova dhe punova  
sa dëgjova dhe mësova  
gjithmonë ty të kujtova.

Tërë jetën s'do harroj  
kush më lindi, më frymëzoi  
ku të jem e ku të shkoj  
sa të jem e sa të rroj  
ty kurrë s'do të harroj

## Zambaku

Tek burimi ujëpak  
mbirë e rritur një zambak  
pranë i rri një vash'për natë  
ai faqet i përflak.

Lulja e kuqe e zambakut  
ulet lehtë e përkëdhel  
pikon lotin prej merakut  
dhe shoqe të tjera çel.

Vasha, këmbët te burimi  
dhe zambaku, po aty  
pse s'puthen u plastë gjiri  
pse nuk ndizen, nuk e di.

## **Mblidhna , Nënë te bajraku**

Një natë marsi të qetë  
u bë një qametë.  
U kthye Vjosa përpjet  
dhe s'derdhet më në det.  
U steros toka me qiell  
lëshon breshëri.  
Për sa kohë s'do dalë diell  
mjerë Shqipëri.  
Do më pakesh nëpër botë  
se të ikin djemtë.  
Do zhuritesh gjer në kockë  
melhem po s'u gjet.  
Do vishesh rrobazezë  
s'do të shteren lotë.  
Do kërkohet zogjtë folenë  
s'do ta gjejnë dot.  
Po mblidhna të gjithë moj nënë  
tek ai bajrak.  
Përse duhet që të derdhet  
dhe një pikë gjak.

## **Rapsodit, Kosovar nga Detroidi**

Dy tela lahute  
mbi dy kontinente  
që nga gradaçelat  
tek fryn erë bjeshke.

T'i paskam zili  
vargjet që më thua  
unë lotin për ty  
ti këngë për mua.

Ç'po më rrahka zemra  
kaq fort e me mall  
duket se lahuta  
në gji më ka marrë.

Ndaj derdhe nga shpirti  
këngë aq të sertë  
këngë aq të buta  
si lulet në shkrepë.

Dy tela lahute  
mbi dy kontinente  
që nga gradaçelat  
tek rrjedh një bjeshke.

## **Ebro na bashkoi**

Albania-Albania  
i shtrenjti vendi im  
rri me një plakë nga Spanja  
në një park në perëndim.



Sa ngjiten fustanellat  
spikerja thotë:Albania  
unë lotin derdh te pena  
ai thith lotët e mia.

Unë hesht e shkruaj këngë  
atij i vijmë kujtime  
unë shpirtin derdh të tërë  
ai në këngë time.

E përgjakur tokë  
të dy na mban mbi supe  
unë gjirin mbushur plot  
ai kujtime lufte.

Dhe buza i dridhet  
një fjalë se thotë dot  
rrokulliste në faqe  
i dhimbshëm një lot.

Ai shqipen se di  
unë spanjishten po ashtu  
si në Ebro kemi mbirë  
të dy bashkë këtu.

Dy breza ne të dy  
nga dy popuj larg  
Ebro na bashkoi  
sonte në një park.

Ebro. Spanjë1996

## **Mustafa Matohitit**

Kurvelesh që linde trima  
drera mali si lastarë  
flakërim si vetëtima  
linde bilbil Mustafanë.

Gjëmave në shekuj  
gjëmave në vite  
djemtë me thërrime  
e barut i rrite.

Bilbil Matohiti  
bilbili me derte  
mbi krye të shqipes  
yll te ylli mbete.

Hallet e popullit tonë  
male me borë ngarkuar  
Marenglenë, ty nuk të lodh  
u vure supet e tua.

Në kasolle, nëpër stane  
ndeze zjarret e lirisë  
gdhendë nëpër zemrat labe  
dashurinë e Shqipërisë.

Margëlliç, kala e sertë  
plumbi i nxehtë ta preu zënë  
kuqon në flamur për jetë  
Labëria këndon këngë.

## Abaz Shehut

Lumi Vlorës atë ditë  
Gjormi, Lepenica flakë  
derdhi plumba mbi armiqtë  
Abaz Shehu kamandant.

Bënça, rrëzë Kurveleshit  
dyzet djem i dha Shqipërisë  
dyzet djem me pallë sheshit  
dyzet yje të lirisë.

I theri zemra Besnikut  
shtrëngon grykën e belçikut  
në Baramyshje, në lëndinë  
hedhin djemtë breshërinë.

Heshti zemra, por jo pushka  
ushtoi në gryka, male  
si zakon që ka vatani  
trimat bien, armës s'varen.

Sa lart e ngriti populli  
emrin tënd, emër heroj  
me mall e me zjarre në zemër  
Labëria ligjëroi.

## S'dihet nata ku më zë

Vashëza ulur në gjunjë  
luante me trëndafilë  
dy gonxhe e jo më shumë  
sumbulla gjiri iu ngjinë.

Gjiret valë u valuan  
zunë të hidhen ngadalë  
hodha syrin e s'pushuan  
hodha dorën e ma vranë.

Ç'është kështu, me vete thashë  
dhe vura buzën nxituar  
përmbi prush sikur rashë  
puth e puth, s'kishin të shuar.

Puth e puth e buza ime  
mori zjarrin si ata  
hodha syrin për burime  
një sumbull mbi buzë ra.

Dhe u rrotullua globi  
rreth vetes, boshtin harroi  
hëna mbeti se pa zoti  
erdhi e fole kërkoi.

Ndaj e dua dashurinë  
që të më dehë gjithnjë  
se në më lëntë pa pirë  
s'dihet nata ku më zë.

## Vasha Përmetare

Hajde, bëjmë poshtë  
nga çairëtë  
vasha ime  
me të ëmbël zë.

Të ma heqësh vallen  
vetëm majë këmbës  
siç e heq sorkadhja  
në dritë të hënës.

Unë të marr lahutën  
avazit t'i bie  
të luash me mua  
si hëna me yje.

T'i rrish trëndafil  
si qerpiku syrit  
si vasha bandillit  
si kënga bilbilit.

Hajde bëjmë poshtë  
nga çairëtë  
unë ia marr me zemër  
ti ia merr me zë.

## Hënëz

Hënë, hënëz ku më vete  
ku më fshihesh as më thua?  
bën sikur apo më epe  
të më bjerë zilia mua.

Bën sikur apo vërtetë  
në ato bahçe me qiell  
harrohesh në muhabet  
dhe unë zihem me diell.

Dielli beqar i plakur  
s'dashuroi asnjë herë  
veç ty t'u firua gjaku  
veshe shtatin në të verdhë.

Pres të dalësh nga meraku  
u firova edhe unë  
dil e buzagaz shfaqu  
ndryshe s'do më shohësh kurrë.

Prit e prit e djalëria  
më iku e ku më vate  
mbledhur në vargjet e mia  
dhe asnjë s'më tha u plake.

Hënë, hënëz ku më vete  
përse nuk me merr edhe mua?  
t'i zbuloj ato lezete  
dhe të të puth gjer në thua.

## Këngët e mia

Në gji të kombit i përkunda këngët  
dhe erën e tij kanë marrë  
ndaj e kanë brumë aq të ëmbël  
sa ngrenë të vdekur, predestalojnë të gjallë.

Në shpuzë të tij i kalita  
ndaj mbetën kështjella në trambundanë  
mëngjesesh i përgjumë i prita  
të thyeshin njëherë si panë.

Në palcë të tij i ushqeva  
të mos i brejë myshku i kohës  
dhe forcën e tyre e ndjeva  
tek mateshin me këngët e botës.

Në prehër të tij le të mbeten  
ushtarë të betuar përjetësisht  
vitet për krahëve do treten  
dhe do kenë jetuar përjetësisht.

## Shokë bimëni longarë

Shokë bimëni longarë  
që ti bie dhe njëherë  
të qaj djemtë që u vranë  
atë ditë në Tepelenë.

Tepelena s'qe goditur  
nga një dhimbje aq e sertë  
për ditë të mira që ngritur  
jo ti mir dyfeku djemtë.

Ato nëna si duruan  
si duruan thikë zemre  
gjiri i tyre kish pikuar  
të mëkonte rrënjë-rrënjë.

Gjaku i djemve i patharë  
u flet nënave pa gjumë  
hallall qoftë gjaku ynë  
po mos derdhtë gjak më shumë.

Ngrihi lulëzoni vendë  
të puth vëllai-vëllanë  
varri ynë nuk do më gjëmë  
varri ynë do të lirë vatanë.

Tepelenë moj Tepelenë  
hiqe moj shaminë e zisë  
mblidhi djemtë, ndërto follenë  
hapi udhën mençurisë.

Mblidhi nënat kokë më kokë  
t'i flasin qumështit të gjirit  
vetëm nëna di o shokë  
si i ulet gjaku birit.

## Kënga labe

Kënga jonë, kënga labe  
mbi ç'taban linde ti vallë  
mbi male, mbi krahë shkabe  
tek lindin trima të rrallë.

Na u bëre shok në halle  
na u bëre krah në luftë  
na ndeze në zemër zjarre  
kur s'kishim u bëre pushkë.

Gjoks më gjoks ty të kënduam  
si shkëmbinj lidhur për mali  
në vargjet e tua qëndruam  
gjithë ç'ranë për vatanë.

Të kënduan në llogore  
të kënduan në çdo shqotë  
isua jote, ortek bore  
herë me gjak e herë me lotë.

Kur s'na ndeze zemrat flakë  
kur s'na dhe nga zjarri yt  
kur s'u hodhe me ne bashkë  
suferinë mbi armiqtë?

O ligjërime bilbili!  
o gurgullime burimi!  
kënga që më sjell në mendje  
zilet, këmborët e dhënve.

## Një natë behari

Një natë behari  
po rrija në hënë  
hëna puthte malin  
mali puthte hënë.

Në puthje të tyre  
m'u ngujua syri  
pastaj kaltërsive  
tek zilepsej ylli.

Me kallinj të mbushur  
thura një gërshetë  
ç'më doli aq bukur  
si ta thurje vetë.

Kulpra lëvizi  
degët ngadalë  
syrin më shkel lisi  
se më kishte parë.

Bulkthi këngën preu  
që të më ndihmonte  
kur heshtjen e theu  
vetëm këmba jote.

Dhe dot nuk arrita  
as kokën të ktheja

yllin të mos shihte  
e mbuloi reja.

Hëna hoqi buzën  
nga buza e malit  
në buzë të prushtë  
u gjenda, i marrë.

Në behar një natë  
po rrija në lëmë  
puthesha me vashën  
luaja me hënë.

## **Ai vit 97**

E njoma vargun me lotin tim  
kënga lotonte në lotin e vargut  
qaja dhe nuk bëja dotë durim  
dielli lindte i zbehtë, hëna e përgjakur.

Buzëqeshjet e ngrira, bëheshin ngërdheshje  
orët hallakateshin, s'e zinin dot kohën  
nga krismat netët lopërisht çaheshin  
mëngjeset s'e gjenin sot portën.

Nënave u ngrinte gjaku në deje  
lehonave u thahej gjiri  
kombi rënkonte në kurbete  
i egër si janari vinte prilli.

Vetëm vaje gatuheshin në vargje  
me një "oi, oi" pambarim  
shkoqeshin dyer, mykeshin pragje  
rrudheshin vasha, mbeteshin jetimë.

Të mençurit heshtnin, të marrët dalldisnin  
gishti kërkon këmbzën, këmbza gjente gishtin  
këndezyt pushonin, pulat kakarisnin  
mbarseshin kodoshët, thoshnin bëmë fisin.

## **Rexhinit**

Shokë do këndojë një këngë  
e kam dert e porosi  
e kam për fshatin e shtrenjtë  
e kam për fshatarët e mi.

Është vrarë e është prerë  
dy shekuj u bë kërdi  
Turku, Greku, Italiani  
dhe Gjermani faqezi.

Pashallarë e agallarë  
me despot e efendi  
pse ky fshat qe Shqiptarë  
tentuan ta bëjnë hi.

Gjith' këto shkuan e vanë  
do mbeten në histori  
fshati im i bukur  
është gjithnjë aty.

## Ali Pashë Tepelena

Atë plagë si e durove  
fol moj Shanisha  
u dashkan dy kontinente  
të mbajnë një pasha.

U dashkan dy kontinente  
të mbajnë Alinë  
vetëtin palla në djepe  
kuje moj Janinë.

Dy kobure grykëndezur  
ndenë në dorë  
bushatllinj të përkëdhelur  
nargjilen kërkojnë.

Në sini kokë e Pashait  
tallet me sulltanë  
një Frosinë ia zuri vajit  
edhe labet qanë.

Frynte një erë Shqipërie  
mjekrën përkëdhel  
Ali Pasha ti e dije  
që kush mbolli vjel.

Ali Pashë zot sinori  
malli më ka marrë  
ngreje Kalo Bosforin  
bëhu prapë i gjallë.

## Xha Aliu

Si lis degëhapur mbi shpatulla të kohës  
rrënjosur thellë në shkëmbinjë tek leu  
rri, xha Aliu, legjendë e murosur  
balli suferin, gjiri shqotën theu.

Për pikën e pikës i kulloi shpirti  
në emër të jetës u teftis i tërë  
u ngjit në qiell, nga qielli zbriti  
se s'rrinte dot pa puthur me rrënjë.

Kur shqipja thëriti në male të lartë  
ajkë djalërie në luftë për liri  
u përgjake nga plumba, u zhurite me flakë  
ti, i kuçioti xha Ali.

Prushi i vatanit kurrë nuk u shua  
vitet e dhimbjet nuk ta mekën zënë  
mbi varrin tënd ligjet e Hallos shkruan  
një këngë trimash me vargje pa thënë.

Në Kuçin e vjetër larë histori  
dëgjohet i qetë akoma hapi yt  
ashtu më erdhe në këngë, xha Ali  
me bastun për dore, ngarkuar me dritë.

## Ah, kjo jeta jonë

Sa herë kufirin kaloj  
zemra pse më ther  
vitet e rinisë kujtoj  
dhe malli më merr.

Kujtoj këngët labërishte  
dhe me zi duroj  
si bilbili në ahishte  
zë e fërgëlloj.

Përpëlitet loti syrit  
dhe zë e pikon  
përvëlon ashtin e gjirit  
Ah! kjo jeta jonë.

Nisemi, s'dimë ku vemi  
mjerë Shqipëri  
me flori kishim mademin  
pse kështu tani?

Pse kështu zë syrgjynosur  
pa gaz e pa shpresë  
gjithë kënga e murosur  
veç urës së Qabesë.

## Bletës

U ul blea përmbi lule  
puthi petalet me krahë  
era fryn, ajo përkundet  
me gjithë lulen si e marrë.

Bletë moj, pse s'më ke thënë  
kush nektarin s'ta ka dhënë?  
të vete t'ia vjel të tërë  
po s'më la ta ha në grënjë.

Bletë moj, ti që bën mjaltë  
as lidhim një besë bashkë  
në mëngjes lulet t'i marësh  
mua dërgomi në darkë.

Në i ke kaq shumë merak  
sa do që t'i mbash për vete  
mos prit që të vijë darkë  
shpërmë atje ku më vete.

## Laku

Në një shteg pas një bërryli  
ngrita lakun, thoni ç'zura  
thash'më kish gënjyer syri  
në lak kish rënë kushulla.

Mirëpo laku s'mbante shumë  
se kushulla që xanaxare  
doemos, s'e kishte pirë  
ujë bore në male.



Unë i fola butë-butë  
hiqe lakun, ç'bën?-më tha  
s'ngrihet laku kaq me ngut  
dhe pse tinëz, nuk të mba.

Në nuk di që trëndelina  
nuk çelet pa ardhur maji  
pse del kot nëpër bërryla  
dhe leqet për vete mbaji.

Iku ashtu e pizmosur  
u ula ndeza cigarin  
shtigjet nuk kanë të sosur  
po lu ndava, zënça varrin.

## Shqipëri mbushur me lule

Shqipëri mbushur me lule  
ç'ke që s'flet por kokën ule?

S'e them dot helmin me gojë  
komb i tërë do rënkojë  
do të rrjedhin lotët lumë  
fëmija do bëhet burrë.

Ç'qe kjo gjëmë kaq e rëndë  
sikur ranë malet të tërë!

Moj nënat e Shqipërisë  
zutë vajin, ç'derte thatë  
nisët kujen për kurbetin  
qajnë gurët në sokak.

Buçet deti e gjëmon mali  
djema, do na marrë malli.

## Kënga ime larë lotë

Kënga ime larë me lot  
mblidhni djemtë, s'i mbledh dot  
udhëve nëpër Evropë  
zemërdjegur nëpër shqotë.

Zemërdjegur, plagëmarrë  
shpresëmekur, gjiri tharë  
syri tretur, jeta vrarë  
s'di nëna në i ka gjallë.

Përvëlur nëpër vapë  
nëpër botë fjetur jashtë  
çarë malet nëpër natë  
hapur nënë zezës plagë.

Për vatanin hani pikur  
mpiksur dhembja nëpër deje  
pakur kombi duke ikur  
përtej detesh e stëreve.

Nënat, motrat ku i gjetën  
ata lotë që nuk u tërë  
për djemtë u përgjërrove  
Shqipëri derë më derë.

Ata bij që nuk u kthenë  
s'u stolisë dot as varrin  
në male, në dete mbenë  
me se do t'ua shuash mallin.

Bën sehir Evropa plakë  
po do kthehen djemtë prapë  
janë rrënjë, janë gjak  
te çdo zemër bajrak.